



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2019

V E N D I M

Nr. 67, Datë 10/06/2019

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 192, datë 18.12.2018, e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, përfaqësuar nga kryetarja e saj, Znj. Gj. N., ku pretendohet për diskriminim të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Shkodrës, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana Bashkisë Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, rezulton se Bashkia Shkodër nuk e ofron më shërbimin e transportit urban falas, për kategorinë e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, sikurse parashikohet nga dispozitat përkatëse ligjore. Znj. Gj. N. thekson faktin se ky institucion ka lidhur kontratë shërbimi me një kompani private/operator shërbimi për ofrimin e shërbimit urban falas, por në kushtet kur Bashkia Shkodër nuk ka derdhur fondin përkatës pranë këtij operatori, ky shërbim nuk ofrohet më. Shoqata shprehet se pavarësisht kërkesave të shumta drejtuar Bashkisë Shkodër, ky institucion nuk ka kryer asnjë veprim për zgjidhjen e problemit në fjalë.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 192, datë 18.12.2018, së Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, përfaqësuar nga kryetarja e saj, Znj. Gj. N., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”². Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 1745/1, datë 21.12.2018, ku kërkohej informacion, si më poshtë vijon:
1. Informacion lidhur me vitin/periudhën kohore, kur ka filluar të ofrohet shërbimi i transportit urban falas për kategorinë e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
 2. Informacion mbi faktin, nëse ky shërbim u është ofruar dhe u ofrohet falas edhe kategorive të tjera në nevojë, përfshirë këtu edhe kategoritë e tjera të individëve me aftësi të kufizuara;
 3. Informacion mbi procedurat që ndiqen nga Bashkia Shkodër, për sigurimin e transportit urban falas për kategoritë në nevojë;
 4. Informacion mbi faktin, nëse Bashkia Shkodër ka lidhur kontratë shërbimi me kompani transporti, për ofrimin e shërbimit falas për kategoritë në nevojë. Nëse po, të përcillet pranë KMD-së një kopje e kontratës së lidhur në vitin 2018, ose kontratës së lidhur në vitin e fundit, përgjatë së cilit është ofruar ky shërbim;
 5. Informacion nëse shërbimi i transportit falas për kategoritë në nevojë është ndërprerë. Nëse po, të evidentohen arsyet përkatëse;
 6. Informacion, nëse Shoqata Shkodrane e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, ka dërguar pranë Bashkisë Shkodër, kërkesa me shkrim apo ankesa lidhur me çështjen në fjalë. Nëse po, të dërgohen pranë Komisionerit kopje të tyre, si dhe të shkresave përgjigje të institucionit tuaj drejtuar kësaj shoqatës;
1. Në përgjigje të shkresës nr. 1745/1, datë 21.12.2018, të Komisionerit, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr.21355/1, datë 07.01.2019, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se në Bashkinë Shkodër ofrohet shërbimi i transportit urban në dy linja qytetase, përkatësisht në linjën Qendër-Shkodër–Shirokë-Zogaj-Qendër-Shkodër dhe në linjën Bahçallëk–Fermentim - Bahçallëk. Ky shërbim ofrohet nga viti 2012 e në vijim.

² Shoqata ka depozituar Vendimin nr. 5443, datë 26.09.2016, të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, nëpërmjet së cilit është regjistruar si person juridik, si dhe statutin e saj;

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Lidhur me çështjen e parë, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon se transporti urban ofrohet falas për kategorinë e invalidëve para dhe tetraplegjikë. Aktualisht, shërbimi i transportit urban në Bashkinë Shkodër, për linjët e sipërpërmendura, ofrohet nga 2 operatorë, mbështetur në kontratat respektive. Linja e parë ofrohet nga operatori “Meni – Ergi” sh.p.k., mbështetur në kontratën e shërbimit nr. 6858 prot., datë 08.05.2018, lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe këtij operatori ekonomik, për një afat 5-vjeçar. Për linjën e dytë, shërbimi urban ofrohet nga operatori ekonomik “Ergys 2010 MS” sh.p.k., mbështetur në kontratën e shërbimit nr. 10011 prot., datë 22.06.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe këtij operatori, për një afat 5-vjeçar.

Lidhur me çështjen e dytë, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon se transporti urban u është ofruar falas të gjitha kategorive të personave në nevojë, përfshirë këtu edhe kategoritë e tjera të invalidëve me aftësi të kufizuar, duke mos diskriminuar asnjë prej tyre. Aktualisht, mbështetur në kontratat e sipërcituara, të lidhura me operatorët respektivë ekonomikë, transporti urban falas është parashikuar për të gjithë kategoritë e veçanta të udhëtarëve, pa asnjë lloj diskriminimi, duke përfshirë këtu edhe invalidët para dhe tetraplegjikë. Në nenin 23, të kontratës nr. 6858, datë 08.05.2018 dhe kontratës nr. 10011 prot, datë 22.06.2018, parashikohet transporti i kategorive të veçanta të pasagjerëve. Për sa më sipër, operatori i linjës me nënshkrimin e kësaj kontrate, merr përsipër respektimin e kudrit ligjor dhe akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, lidhur me transportin falas të kategorive të veçanta të udhëtarëve, ndër të cilët edhe invalidët para dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre. Ky detyrim i operatorit ekonomik parashikohet edhe në çertifikatat për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetase.

Lidhur me çështjen e tretë, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon se ky institucion merr masat respektive për sigurimin e transportit falas për kategoritë në nevojë, mbështetur në nenin 23, të kontratave të sipërcituara.

Lidhur me çështjen e katërt, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon dhe rithekson faktin e përmendur edhe më sipër se ky institucion ka lidhur dy kontrata shërbimi për transportin e udhëtarëve duke parashikuar transportin falas të kategorive në nevojë pa asnjë lloj diskriminimi.

Lidhur me çështjen e pestë, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon se shërbimi i transportit falas për kategoritë në nevojë nuk është ndërprerë asnjëherë.

Lidhur me çështjen e gjashtë, për të cilën Komisioneri ka kërkuar informacion, Bashkia Shkodër informon se pranë këtij institucioni nuk është administruar asnjë kërkesë me shkrim apo ankesë, qoftë edhe verbale, lidhur me çështjen në fjalë, nga Shoqata Shkodrane e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës.

Në përfundim të shkresës nr.21355/1, datë 07.01.2019, theksohet fakti se Bashkia Shkodër zbaton kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, me qëllim ofrimin e shërbimeve, duke

respektuar parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit për grupet vunerabël, përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuar.

2. Në vijim, Shoqata Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës iu drejtua Komisionerit me kërkesën e datës 21.01.2019, nëpërmjet së cilës kërkon të disponojë një kopje të informacionit të dërguar nga Bashkia Shkodër.
3. Nëpërmjet shkresës nr. 146, datë 28.01.2019, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i dërgoi shoqatës së sipërpërmendur një kopje të shkresës nr. 21355/1, datë 07.01.2019, së Bashkisë Shkodër dhe materialeve bashkëlidhur.
4. Pas njohjes me përmbajtjen e informacionit të dërguar nga Bashkia Shkodër, Shoqata Shkodrane e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës dërgoi pranë KMD-së, shkresën e datës 04.02.2019, nëpërmjet së cilës shpreh kundërshtimet e saj ndaj përgjigjes zyrtare të dërguar nga Bashkia Shkodër.

Në shkresën e dërguar nga kjo shoqatë sqarohet fakti se ne pretendimet e parashtruara në ankesën e saj drejtuar KMD-së nuk është mohuar fakti që Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata shërbimi me shoqëri private, për ofrimin e shërbimeve të transportit publik në qytet, por pretendimet e saj konsistojnë në faktin se shërbimi urban për kategorinë e personave para dhe tetraplegjikë nuk ofrohet falas. Shoqata thekson faktin se si pasojë e mos ofrimit falas të shërbimit urban ndaj individëve që i përkasin kësaj kategorie ka patur protesta gjatë muajit janar 2019. Individët para dhe tetraplegjikë detyrohen të paguajnë biletën e shërbimit urban edhe pse janë të pajisur me kartën e invaliditetit. Një gjë e tillë ka ndodhur, pasi Bashkia Shkodër nuk ka alokuar fondin përkatës në llogari të operatorëve të shërbimit, duke mos përmbushur detyrimet kontraktore.

- C. Në vijim të ndjekjes së procedurave të shqyrtimit administrativ, nëpërmjet shkresës nr. 194, datë 07.02.2019, Komisioneri i njoftoi palët për seancë dëgjimore, e cila u vendos të realizohet në datën 04.03.2019, ora 11:00, pranë Zyrës së KMD-së.

Në seancë dëgjimore u paraqit pala ankuese e përfaqësuar nga Znj. Gj. N., kryetare e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës dhe Z. V. M., përfaqësues i Bashkisë Shkodër.

Znj. Gj.N. parashtrroi në seancë dëgjimore edhe një pretendim të shoqatës që ajo përfaqëson, për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe përkthësisë në një grup të veçantë, të kategorisë së personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nga ana e Bashkisë Shkodër, si pasojë e mos sigurimit të transportit urban qytetas falas, sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Znj. Gj. N. theksoi faktin se duke filluar nga data 15 janar 2019, transporti falas për këtë kategori individësh me aftësi të kufizuar është ndërprerë, pasi operatorët e shërbimit urban nuk kompensohen nga Bashkia Shkodër, për ofrimin e transportit falas për individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të këtij qyteti.

Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër u shpreh se Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata shërbimi me 2 (dy) operatorë të shërbimit urban, për një periudhë 5 vjeçare. Në këto kontrata parashikohet ofrimi i shërbimit urban falas për disa kategori vunerabël, ndër të cilat edhe për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Z. V.M. depozitoi në cilësi prove, shkresën nr. 3129, datë 28.05.2014, të Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, drejtuar të gjithë Kryetarëve të Bashkive dhe për dijeni Prefektëve të Qarqeve, ku i informon se ligji nr. 37/2014, datë 10.04.2014, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar”, për momentin mbetet i pazbatueshëm, për sa kohë nuk janë miratuar aktet nënligjore përkatëse. Në nenin 3 të këtij ligji parashikohet se: *“Fondet për kompensimit e tarifës së transportit të kategorisë së personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohen nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”* Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër u shpreh se deri tani aktet nënligjore që përcaktojnë masat, kriteret procedurat për kompensimin e tarifave nuk kanë dalë ende, pasi mbështetur në shkresën e mësipërme, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është ende në procesin e vlerësimit dhe hartimit të projektvendimeve për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të shërbimit të transportit për kategoritë që përfitojnë lehtësira sipas legjislacionit në fuqi. Ministri përgjegjës udhëzon Kryetarët e Bashkive, që të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale, mbi këtë të drejtë të invalidëve të punës nga shoqëritë e transportit. Përfaqësuesi i Bashkisë Shkodër u shpreh se me Urdhër të Kryetares së Bashkisë Shkodër është ngritur një grup monitorimi, për kontrollin e vazhdueshëm ndaj njërit prej operatorëve të shërbimit urban, i cili është paraqitur problematik, lidhur me zbatimin e kontratës së shërbimit, për sa i përket ofrimit të shërbimit urban falas për kategoritë vunerabël, pasi ka patur shqetësime dhe ankesa nga disa shoqata lidhur me këtë operator. Ky operator është “Ergys 2010 MS” sh.p.k. Gjithësesi, Z. V. M. u shpreh se e gjithë problematika lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mungesën e aktit përkatës nënligjor, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurën e kompensimit për transportin falas të kategorive të veçanta të personave me aftësi të kufizuara.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua dy operatorëve të shërbimit urban, me të cilët Bashkia Shkodër ka lidhur kontratë shërbimi me shkresën nr.369, datë 07.03.2019, ku kërkon informacion mbi mënyrën se si po zbatohet neni 23, i kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë Shkodër dhe nëse nga ana e tyre është konstatuar ndonjë problematikë, lidhur me zbatimin e kësaj dispozite, që konsiston në ofrimin falas të shërbimit urban për kategoritë e veçanta.

1.1.Në përgjigje të shkresës nr.369, datë 07.03.2019, të Komisionerit, operatori i shërbimit urban “Ergys 2010 MS” sh.p.k. dërgoi shkresën nr. 40, datë 11.03.2019, nëpërmjet së cilës sqaron se shoqëria ka realizuar transportin falas të kategorive, që përfitojnë këto lehtësi nga viti 2012, e deri në datën 15.02.2019. Kjo shoqëri shprehet se ka shprehur në mënyrë të përsëritur shqetësimin pranë Bashkisë Shkodër, për zbatimin e nenit 85, të

ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe kryerjen e kompensimit, lidhur me ofrimin e transportit falas për këtë kategori personash.

1.2. Shoqëria “Meni Ergi” sh.p.k nuk i dërgoi përgjigje shkresës nr.369, datë 07.03.2019, së Komisionerit.

2. Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioneri iu drejtua Bashkisë Shkodër, me shkresën nr. 369, datë 07.03.2019, nëpërmjet së cilës i kërkon informacion mbi disa çështje, të cilat u diskutuan në seancë dëgjimore dhe për të cilat u ra dakord, që informacioni do të dërgohej në vijim të seancës dëgjimore. Këto çështje parashtrohen si më poshtë:

1. Kopje të korrespondencës zyrtare së Bashkisë Shkodër me institucione të tjera përgjegjëse, ku objekt i kësaj korrespondence, të ketë qënë sigurimi i transportit urban falas për personat me aftësi të kufizuar;
2. Kopje të shkresave zyrtare të dërguara nga institucionet përgjegjëse, ku të evidentohet udhëzimi i dhënë nga to, mbi mënyrën se si do të procedohej nga institucioni juaj, në mungesë të aktit përkatës normativ, lidhur me përcaktimin e masës dhe kritereve për kompensimin e individëve me aftësi të kufizuar;
3. Informacion lidhur me procedurën e ndjekur prej vitit 2012 e në vijim nga Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me operatorët e shërbimit urban, për të siguruar transportin falas të individëve me aftësi të kufizuar;
4. Informacion i detajuar mbi problematikën e shfaqur me operatorët e shërbimit urban, lidhur me ofrimin falas të shërbimit urban, për kategoritë vunerabël, si dhe periudhat kohore kur janë shfaqur këto problematika;
5. Akti administrativ, lëshuar nga kryetarja e Bashkisë Shkodër, për kryerjen e monitorimit të operatorëve të shërbimit urban, lidhur me ofrimin falas të shërbimit ndaj personave më aftësi të kufizuar, si dhe Raporti përkatës mbi përfundimet e monitorimit të kryer;
6. Hapat vijues që do të ndërmarrë Bashkia Shkodër, në vijim të konstatimeve dhe përfundimeve, në këtë raport monitorimi.

2.1 Në përgjigje të shkresës nr. 369, datë 07.03.2019, së Komisionerit, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 5585, datë 05.04.2019, nëpërmjet së cilës sqaron mbi çështjet për të cilat KMD ka kërkuar informacion. Në lidhje me çështjet 1 dhe 2, për të cilat Komisioneri kërkon informacion, Bashkia Shkodër përcjell korrespondencën që ka patur me disa institucione përgjegjëse. Lidhur me çështjen 3, Bashkia Shkodër sqaron se detyrimi i operatorëve të shërbimit urban për t’iu siguruar transport falas kategorive në nevojë, është përcaktuar në kontratat e shërbimit të lidhura në vitin 2018. Lidhur me pikën 4, ky institucion informon se mungesa e akteve nënligjore ka sjellë si pasojë mosmarrëveshje me operatorët e shërbimit urban. Lidhur me çështjen 5, Bashkia Shkodër përcjell pranë KMD-së, Urdhërin nr. 72, datë 06.02.2019, e Kryetares së Bashkisë Shkodër, “Për kontrollin dhe monitorimin e shërbimit

urban”, duke theksuar faktin se raporti përkatës nuk ka përfunduar ende, pasi ky institucion është ende në fazën e verifikimit të dokumentave të subjektit në institucionet e tjera. Lidhur me çështjen 6, Bashkia Shkodër informon se ndodhet në procesin e monitorimit e vlerësimit dhe pas verifikimit të dokumentave që ka operatori në institucionet e tjera, si pjesë e raportit të monitorimit do të hartohet raporti. Më pas, ky institucion informon se do të veprojë sipas përcaktimeve në kontratë, me qëllim krijimin e lehtësirave të lëvizjes për kategoritë e personave në nevojë.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 192, datë 18.12.2018, e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, përfaqësuar nga kryetarja e saj, Znj. Gj. N., pretendohet për diskriminim të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të qytetit të Shkodrës, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”* dhe *“përkatësisë në një grup të veçantë”*, nga ana Bashkisë Shkodër.

Ky diskriminim i pretenduar nga shoqata e sipërpërmendur mbështetet në faktin se invalidëve para dhe tetraplegjikë në qytetin e Shkodrës nuk u ofrohet shërbimi i transportit urban qytetas falas, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi⁴ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas⁵ dhe (3) transport ndërqytetas⁶. Transporti qytetas që përbën objektin e kësaj ankese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

- 1) Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitimin e transportit falas për kategorinë individëve paraplegjikë – tetraplegjikë, Komisioneri, mori në analizim Ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”* (i ndryshuar). Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i

⁴ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

⁵ Transporti rrethqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

⁶ Transporti ndërqytetas nuk bën pjesë në objektin e shqyrtimit të kësaj ankese.

këtij ligji parashikonte shprehimisht: “Udhëtimi urban i të sëmurëve paraplegjik dhe tetraplegjik, bashkë me shoqëruesin e tyre, bëhet falas në mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat, ndërsa udhëtimi interurban rimbursohet nga shteti në masën 50% të vlerës”.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”. Aktualisht, ky nen parashikon: “Të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik, bashkë me shoqëruesit e tyre, përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar), individët paraplegjikë/tetraplegjik nuk përfitojnë më transport qytetas/urban⁷ falas dhe transport interurban⁸/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Edhe legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban qytetas, për shtresat dhe kategoritë vunerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori. Për sa më sipër, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)⁹ parashikon:

“Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjjes për ta.

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Fondet për kompensimin e tarifës së transportit të kategorive të personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohet nga institucionet përgjegjëse, sipas

⁷ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁸ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁹ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 37/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 21/2013, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 10 302, datë 15.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”).

ligjit. Masa, kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Për sa më sipër, edhe neni 85, i ligjit 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar, ka vendosur detyrimin dhe ka autorizuar nxjerrjen e një akti nënligjor nga e Këshillit të Ministrave, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurat për kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Ky akt nënligjor nuk rezulton të jetë miratuar.

Në referencë të akteve nënligjore të miratuara në fushën e transportit, Komisioneri është fokusuar edhe në parashikimet e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor", ku është përcaktuar se të drejtën për të përcaktuar çmimet e biletave për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transportin qytetas/rrethqytetas me ligje të veçanta, e kanë, këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim. Pika 7, e Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor" parashikon: "Për udhëtarët, që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, çmimi i biletave për transportin qytetas dhe rrethqytetas caktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë qëllim, me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore".

Në referencë të Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", Bashkitë janë organet kompetente për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për operatorët e shërbimit urban qytetas.

Në vijim, vlen të përmendet edhe Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, "Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve". Ky udhëzim bën një identifikim të grupeve, që përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë. Individët që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbrit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e individit paraplegjik/tetraplegjik gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të treja format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas. Transporti qytetas dhe rrethqytetas, janë kompetencë e pushtetit vendor. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, pushteti vendor ka kompetencën për të përcaktuar linjat, për të liçensuar subjektet dhe për të përcaktuar çmimin e biletave për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport. Kjo kategori është

përfituese e kompesimit, i cili nuk është përcaktuar akoma në çfarë mase, si dhe nuk janë përcaktuar kriteret për përfitim e tij, pasi nuk është miratuar ende ankti nënligjor, që duhet të bëjë përcaktime të tilla.

Nga dokumentacioni i depozituar nga Bashkia Shkodër rezulton se problematika e mospërfitimit të lehtësirave në transportin urban qytetas është një problematikë e parashtruar më së shumti nga Shoqata e Invalidëve të Punës së Shqipërisë, Dega Shkodër. Kjo shoqatë ka depozituar disa kërkesa dhe ankesa, jo vetëm pranë Bashkisë Shkodër, por edhe në institucione e dikastere të tjera të pushtetit qendror, lidhur me sigurimin e lehtësirave në transportin publik qytetas.

Nisur nga problematika e paraqitur nga Shoqata e Invalidëve të puëns së Shqipërisë, Dega Shkodër, edhe më gjerë, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i është drejtuar, nëpërmjet shkresës nr. 3129, datë 28.05.2014, të gjithë Kryetarëve të Bashkive dhe për dijeni Prefektëve të Qarqeve, ku nisur nga problematika e paraqitur nga shoqatat e invalidëve të punës, lidhur me sigurimin e lehtësive në transportin urban për këtë kategori, i udhëzon titullarët e këtyre institucioneve, si vijon: *“Aktualisht, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë është në procesin e vlerësimit dhe të hartimit të projektvendimeve për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të shërbimit të transportit për kategoritë që përfitojnë lehtësira në transport sipas legjislacionit në fuqi. E drejta e invalidëve të punës për udhëtimin falas në mjetet e komunikacionit qytetas privat është e përcaktuar edhe në dokumnetacionin liçencues dhe çertifikues të shoqërive të transportit.....Duke qenë se autoritetet përgjegjëse për lëshimin e këtyre liçencave janë njësitë e qeverisjes vendore, ato duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e detyrimeve të parashikuara në liçencë për subjektet që kryejnë transport rrugor. Në rast të kundërt mund të kërkojnë heqjen e liçencës për subjektet që nuk i përmbushin këto detyrime. Nga sa më lart, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë kërkon zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe detyrimeve që kanë shoqëritë e transportit bazuar në dokumentacionin e tyre liçencues dhe çertifikues, në lidhje me të drejtën e invalidëve të punës për udhëtim falas me mjetet e komunikacionit qytetas privat. Gjithashtu kërkojmë vëmendjen e njësisve të qeverisjes vendore në mbikqyrjen e vazhdueshme të respektimit të detyrimeve kontraktuale mbi këtë të drejtë të invalidëve të punës nga shoqëritë e transportit”.*

Referuar akteve të depozituara në cilësinë e provës nga Bashkia Shkodër, rezulton se ky institucion i është drejtuar në vijim zyrtarisht ish-Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (sot Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale), nëpërmjet shkresës nr. 10543, datë 16.11.2015, ku i kërkohet zgjidhje, lidhur me përcaktimin e masës, kriterëve dhe procedurave për kryerjen e kompensimit të shërbimit të transportit urban për kategori që përfitojnë lehtësi. Nga Bashkia Shkodër nuk është depozituar ndonjë përgjigje zyrtare e dërguar nga Ministria.

Për sa më sipër, rezulton se pavarësisht mungesës së aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë masën, kriteret dhe procedurat e kompensimit të shërbimit të transportit për kategorinë e invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe vonesës së zgjatur për nxjerrjen dhe miratimin e këtij akti nënligjor, ministri përgjegjës i ka dhënë një zgjidhje të përkohëshme çështjes në fjalë, duke mos cënuar të

drejtën e invalidëve të punës, sikurse për analogji edhe individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për të gëzuar lehtësi në transportin urban qytetas. Për të realizuar një shërbim të tillë, në mungesë të aktit nënligjor ende të pamiruar, ai udhëzon që njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të kompetencave që atyre u atribuon legjislacioni në fuqi, të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorëve të shërbimit urban, si dhe u kujton këtyre njësitë se e drejta e transportit falas të kategorive të individëve me aftësi të kufizuar është e përcaktuar në dokumentacionin licencues dhe certifikues të shoqërive të transportit, ku këto të fundit lëshohen nga organet e qeverisjes vendore.

- 2) Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri analizoi edhe përmbajtjen e Kontratave të Shërbimit, të lidhura ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorëve të shërbimit urban, përkatësisht Kontratës së Shërbimit nr. 6858, datë 08.05.2018, “*Për transportin e udhëtarëve në linjën qytetëse “Qendër-Shirokë-Zogaj-Qendër” të Bashkisë Shkodër, të lidhur me Shoqërinë “Meni Ergi” sh.p.k. dhe Kontratës nr. 10011, datë 22.06.2018, “Për transportin e udhëtarëve në linjën qytetëse “Bahçallëk-Fermentim-Bahçallëk” të Bashkisë Shkodër, të lidhur me Shoqërinë “Ergys 2010MS” sh.p.k. Neni 23 “Transporti i kategorive të veçanta”, i këtyre kontratave të sipërpërmendura parashikon shprehimisht: “Operatori i linjës me nënshkrimin e kësaj kontrate, merr përsipër respektimin e kuadrit ligjor dhe akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, lidhur me transportin e kategorive të veçanta të udhëtarëve, si:*
- a. *studentët dhe nxënësit*
 - b. *udhëtimin falas të kategorive të mëposhtëme që zotërojnë librezën përktëse të lëshuar nga organet kompetente:*
 - i. *invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre;*
 - ii. *veteranët e luftës;*
 - iii. *të verbërit dhe shoqëruesit e tyre;*
 - iv. *invalidët e punës;*
 - v. *personat me aftësi të kufizuara*
 - vi. *jetimët nga 0-25 vjeç.”*

Për sa më sipër, rezulton se operatorët e shërbimit urban, me të cilët Bashkia Shkodër ka lidhur kontratë shërbimi, e kanë detyrim kontraktual ofrimin e shërbimit urban qytetas falas për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Në rastin konkret, sipas informacionit të përcjellë nga Bashkia Shkodër rezulton se që prej fillimit të vitit 2019, Shoqëria “Ergys 2010MS” sh.p.k. nuk e ka zbatuar këtë parashikim të kontratës, pasi ka kërkuar kompensim për ofrimin e shërbimit urban falas nga ky institucion për kategoritë në nevojë. Neni 27, i kontratave të mësipërme parashikon afatet e përbushjes së detyrimeve nga ana e operatorëve të shërbimit urban. Në këtë nen parashikohet se në rast të mospërbushjes së detyrimeve të kontratës, Bashkia vendos masat e përcaktuara në Urdhëresën nr. 606/2017 dhe nenit 33 të kësaj kontrate dhe shtyn afatet e përbushjes së këtyre detyrimeve rast pas rasti, por jo më shumë se 30 ditë

kalendarike. Në rast se edhe pas kësaj periudhe, detyrimet nuk përmbushen, Bashkia revokon licencën dhe zgjidh në mënyrë të njëanshme të kontratën.

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Bashkia e Shkodrës i ka patur të gjitha mundësitë për të mos e lënë të thellohej problematika e mos ofrimit të shërbimit të transportit urban falas, jo vetëm për kategorinë e individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, por edhe për kategoritë e tjera të parashikuara në nenin 23, të kontratave të shërbimit, të lidhura me operatorët e shërbimit urban qytetas.

Përveç sa më sipër, Bashkia Shkodër, në cilësinë e autoritetit që lëshon licencat dhe certifikatat për operatorët e shërbimit urban, në referencë të pikës 4, të Lidhjes 4, së Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe *Infrastrukturës* “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, ku parashikohet: “Mbajtësi i licencës dhe i kësaj certifikate mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet: a) **Për transportin qytetës**: - “invalidët e punës, invalidët e luftës, **invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë**, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, nr. 8153/96, të ndryshuar; - “të verbërit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”, dukej të kishte vepruar menjëherë kundrejt moszbatimit të këtij udhëzimi.

Nga analizimi i certifikatave, lëshuar automjeteve përkatëse, të dy operatorëve të shërbimit urban, me të cilët Bashkia Shkodër ka lidhur kontratë shërbimi urban qytetas në vitin 2018, rezulton se në Lidhjen 4, Faqja e tretë e Certifikatës nr. 1, Dispozita të Përgjithshme, pika 4, të secilës Certifikatë parashikohet: “Mbajtësi i licencës dhe i certifikatës mban përgjegjësi për zbatimin e ligjeve nr.7889/94, të ndryshuar, nr. 7663/93, nr. 8626/00, të ndryshuar në të cilat përcaktohet: a) **Për transportin qytetës**: - “invalidët e punës, invalidët e luftës, **invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë**, të cilët nga organizatat përkatëse janë të pajisur me dëshmi, kanë të drejtë të udhëtojnë falas”, si dhe për zbatimin e ligjeve nr. 8098/96, nr. 8153/96, të ndryshuar; - “të verbërit e shoqëruesit e tyre dhe jetimët që nuk janë në marrëdhënie pune, udhëtojnë falas”.

Referuar gërmës d), të pikës 8.1, të Lidhjes 1 “Dispozita të Përgjithshme”, të Licencës nr. 2 “Për kryerjen e shërbimeve të rregullta qytetase të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit” lëshuar subjektit “Ergys 2010MS”, nga Bashkia Shkodër, rezulton se: “Licenca pezullohet nga autoriteti i licencimit, që e ka lëshuar atë, kur mbajtësi i saj: d) Nuk zbaton legjislacionin në fuqi, për personat me aftësi të kufizuar, të konstatuara nga organet e kontrollit.” Në rastet e sipërcituara, autoriteti i licencimit, pezullon licencën e subjektit të transportit dhe i lë një afat 21 ditor për plotësimin e mangësive të konstatuara”. Ky parashikim ndiqet nga ai i pikës 8.2, i së njëjtës Lidhje, ku përcaktohet: “8.2 Autoriteti kompetent i licencimit, do të heqë licencën kur mbajtësi i saj: e) nuk zbaton legjislacionin në fuqi në mënyrë të përsëritur, të konstatuara nga organet e kontrollit, për personat me aftësi të kufizuar.”

Për sa më sipër, sërisht rezulton që, Bashkia Shkodër i ka patur të gjitha mundësitë për të ndërhyrë kundrejt moszbatimit të akteve të mësipërme, nga ana e operatorit urban Shoqëria “Ergys 2010MS” sh.p.k.

Mbështetur në provat shkresore të depozituara, rezulton se Bashkia Shkodër i është drejtuar zyrtarisht operatorit të shërbimit urban “Ergys 2010MS”, kryetarit të Shoqatës së Invalidëve të Punës, Dega Shkodër dhe për dijeni Prefektit të Qarkut Shkodër nëpërmjet shkresës nr. 159, datë 12.01.2015, ku ky institucion kërkon nga operatori i sipërpërmendur të mos nxjerrë pengesa për udhëtimin falas të kategorive të veçanta, deri në momentin e miratimit të aktit nënligjor, që do të përcaktojë masat, procedurat dhe kriteret e kompensimit të transportit për invalidët e punës.

Bashkia Shkodër i është drejtuar sërisht zyrtarisht operatorit të shërbimit urban “Ergys 2010MS”, si dhe për dijeni kryetarit të Shoqatës së Invalidëve të Punës, Dega Shkodër, nëpërmjet shkresës nr.9085, datë 21.10.2015,

Në vijim, sërisht, Bashkia Shkodër rezulton t’i jetë drejtuar zyrtarisht operatorit të shërbimit urban “Ergys 2010MS”, si dhe për dijeni kryetarit të Shoqatës së Invalidëve të Punës, Dega Shkodër, nëpërmjet shkresës nr.10541, datë 16.11.2015, ku citohet: *“Shoqata e Invalidëve të Punës me shkresën nr. 13 prot., datë 11.11.2015, na informon se situatë e transportit të invalidëve të punës mbetet përsëri e pazgjidhur edhe pas shkresës sonë me Nr. 9085 Prot., datë 21.10.2015, si dhe takimit të organizuar këtu në Bashki. Për sa më sipër tërheqim vëmendjen që kjo situatë duhet të marrë fund deri në zgjidhjen përfundimtare për të cilën edhe Bashkia po përpigjet me organet kompetente për këtë problem. Ju kujtojmë se deri atëherë ju duhet të zbatoni nenet 22, për transportin e kategorive të veçanta të pasagjerëve dhe nenet 36 dhe 37 të Kreut X “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve” të shprehura në kontratat nr Nr. 3287 dhe 3289, datë 31.08.2012, pasi në të kundërt do të ndjekim rrugët ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.”*

Mbështetur sërisht në provat shkresore të depozituara, Komisioneri i referohet shkresës nr. 217, datë 08.01.2018, të Bashkisë Shkodër, drejtuar operatorëve të shërbimit urban, ndër të cilëve edhe subjektit “Ergys 2010MS”, ku u silllet në vëmendje zbatimi i Udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016 *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumnetacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”*. Në shkresën e sipërpërmendur, citohet shprehimisht neni 14, pika 5, e Udhëzimit të sipërpërmendur, duke vënë në dukje detyrimin e subjekteve për të zbatuar legjislacionin në fuqi për personat me aftësi të kufizuara dhe për t’u krijuar sa më shumë lehtësira për transport kësaj kategorie udhëtarësh. Në këtë shkresë citohet shprehimisht: *“Moszbatimi i legjislacionit në fuqi për transportin e personave me aftësi të kufizuara përbën shkelje të rëndë, e cila shkon deri në pezullimin ose heqjen e liçencës dhe, certifikatës së autobusit.”*

Për sa më sipër, rezulton se operatori i shërbimit urban “Ergys 2010MS” sh.p.k. ka shfaqur problematika në ofrimin e lehtësive në transport ndaj kategorive të mirëpërcaktuara në Kontratën e

Shërbimit të lidhur me Bashkinë Shkodër, në vitin 2012. Pavarësisht problematikave të reflektuara në shkresat e mësipërme, që i përkasin vitit 2015, rezulton se Bashkia Shkodër ka lidhur sërish Kontratë Shërbimi, në vitin 2018, me këtë operator shërbimi. Një fakt i tillë e rëndon pozitën e këtij institucioni, në kushtet kur, ka përsëritje të problematikës së refuzimit të ofrimit të shërbimit falas ndaj kategorive në nevojë, nga ky operator.

- 3) Nga informacioni i përcjellë nga Bashkia Shkodër, rezulton se në bazë të Urdhërit nr. 72, datë 06.02.2019, të Kryetares së Bashkisë Shkodër, “Për kontrollin dhe monitorimin e shërbimit urban”, është ngritur një grup kontrolli, monitorimi dhe inspektimi i shërbimit urban në këtë qytet. Referuar pikës 2, të këtij urdhëri, detyra e këtij grupi është të monitorojë e të kontrollojë zbatimin e kontratës së lidhur ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe operatorëve që kryejnë shërbimin e transportit urban. Ndër detyrat e grupit të punës, bën pjesë edhe “monitorimi i udhëtimit pa bileta të personave dhe kategorive të ndryshme sociale”. Në pikën 3 të këtij Urdhëri, përcaktohet se kontrollet duhet të jenë periodike për secilën linjë dhe për çdo kontroll, grupi i punës duhet të hartojë një raport.

Nëpërmjet shkresës nr. 369, datë 07.03.2019, drejtuar Bashkisë Shkodër, Komisioneri ka kërkuar ndër të tjera, “informacion lidhur me hapat vijues që do të ndërmerren ky institucion, në vijim të konstatimeve dhe përfundimeve në raportin e monitorimit”. Në shkresën nr. 5585, datë 05.04.2019, të Bashkisë Shkodër drejtuar Komisionerit, lidhur sa më sipër, Bashkia Shkodër e ka bërë me dije KMD-në: “Për sa kërkonte në pikën 6, jemi në proces të monitorimit, vlerësimit dhe pas verifikimit të dokumentave që ka operatori në institucionet e tjera, si pjesë e raportit të monitorimit do të hartohet raporti. Më pas do të operohet sipas përcaktimeve në kontratë me qëllim krijimin e lehtësirave të lëvizjes për kategoritë e personave në nevojë”.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)¹⁰ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret Bashkisë Shkodër. Në këtë rast, Bashkia Shkodër duket të provonte se nga ana e saj janë marrë të gjitha masat e nevojshme për rregullimin e situatës në lidhje garantimin e transportit qytetës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe ndaj operatorëve të shërbimit urban, që kanë rezultuar në shkelje të parashikimeve të kontratës së shërbimit, apo dispozitave të Përgjithshme të Çertifikatave dhe Liçencave të lëshuara ndaj tyre.

Në shkresën nr. 5585, datë 05.04.2019, të Bashkisë Shkodër drejtuar Komisionerit, nuk rezulton më të ketë pasur përpjekje nga ana e Bashkisë për rregullimin përfundimtar të situatës së asaj duke

¹⁰ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

shfrytëzuar legjislacionin në fuqi ashtu edhe në lidhje me pushtetin qëndror. Gjithashtu, në asnjë rast nuk është përmendur vënia e sanksioneve përkatëse ndaj operatorit, që rezulton nga procesi i kontrollit se ka shkelur dispozitat e kontratës së shërbimit, si dhe ky institucion nuk ka dërguar pranë Komisionerit asnjë raport të grupit të kontrollit, përgjatë 3 muajve, që ky grup ka ushtruar kontroll dhe ka monitoruar operatorët e shërbimit urban qytetas në Shkodër.

Njëkohësisht, mbështetur në provat shkresore të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se operatori i shërbimit urban “Ergys 2010MS” sh.p.k. është një subjekt që ka paraqitur problematika, që në vitin 2015, lidhur me mos ofrimin e lehtësirave të shërbimit urban falas ndaj kategorive në nevojë, ndërmjet tyre edhe ndaj kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë. Me nënshkrimin e dy Kontratave të Shërbimit të lidhura në vitin 2012 dhe 2018, me Bashkinë Shkodër, ky subjekt ka rënë dakord, me vullnetin e tij të plotë, për ta kryer një shërbim të tillë. “Ergys 2010MS” sh.p.k. ka shkelur parashikimet e kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë Shkodër, sikurse edhe përcaktimeve në licencë dhe çertifikatat e automjeteve, dhe ndaj tij Bashkia Shkodë ka marrë asnjë masë.

Komisioneri gjykon se në referencë të nenit 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Bashkia Shkodër e ka ekspozuar kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues.

A. Shkaku i mbrojtur.

Në ankesën nr. 192, datë 18.12.2018, e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, përfaqësuar nga kryetarja e saj, Znj. Gj. N., pretendohet diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana Bashkisë Shkodër.

1. *“Aftësia e kufizuar” është njëri prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në lidhje me pretendimin e shoqatës anekese për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë.

2. *“Përkatësia në një grup të veçantë” është një prej shkaqeve, për të cilët, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij,*

përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në lidhje me pretendimin e shoqatës ankuese për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, Komisioneri gjykon se ky shkak konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që e justifikojnë si të tillë. Kategoria e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë është një grup i veçantë, brenda kategorisë së përgjithshme të personave me aftësi të kufizuar.

B. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

B/1. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me aftësinë e kufizuar.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”¹¹ në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: “Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”

Në frymën e Konventës, është miratuar, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme,

¹¹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Ligji nr. 93/2014, përcakton se, një nga aspektet që siguron jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara është edhe *transporti*. Në gërmën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: *“Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e, ndër të tjera, të kenë akses përkatësisht:ë) në transport....”*. Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, *jetesa e pavarur*, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave. Në këto shërbime përfshihen ndër të tjera edhe *transporti*.

Me qëllimin nxitjen e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre, Qeveria shqiptare ka miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 483, datë 29.06.2016, *“Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020”*. Në analizën e situatës, për sa i përket aksesueshmërisë fizike, në Planin e Veprimit konstatohet se: *“Nevojitet një transport i aksesueshëm, i përballueshëm dhe efikas për të bërë të mundur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, për të lehtësuar lirinë e lëvizjes dhe për të nxitur pjesëmarrjen në punësim, arsimim dhe aktivitete të tjera.....”*

Sikurse është përmendur edhe në rubrikat e sipërpërmendura, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për transportin urban qytetas. Në pikën 6, të nenit 23 *“Funksionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”*, të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”* parashikohet: *“Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:6. Transportin publik vendor”*.

Neni 26, i ligjit të sipërpërmendur, parashikon: *“Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtetas në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

Nisur nga legjislacioni i sipërcituar Komisioneri vëren se Bashkia Shkodër ka dështuar në marrjen e masave për heqjen e të gjitha pengesave institucionale, për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuara.

Ky dështim lidhet me tre momente kryesore:

Së pari, Bashkia Shkodër i ka ndërprerë përpjekjet e saj me pushtetin qendror për t’i dhënë një zgjidhje përfundimtare situatës, në lidhje me përcaktimin e masave, kritereve dhe procedurat për

kompesimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Korrespondenca e fundit shënohet në vitin 2015 dhe pas këtij viti nuk rezulton më interesim nga ana e Bashkisë Shkodër, për të nxitur Këshillin e Ministrave në nxjerrjen e aktit nënligjor për masat, kriteret dhe përfitimin e kompensimit për personat me aftësi të kufizuar.

Së dyti, pavarësisht kësaj, Bashkia Shkodër ka pasur të gjithë mundësinë për zgjidhjen vetë të situatës konkrete, nisur nga fakti që transporti qytetas është funksion i saj, ekskluziv, për t'ia garantuar të gjithë banorëve të saj¹², duke garantuar përkujdesje sociale të veçantë për personat me aftësi të kufizuar¹³. Pikërisht në funksion të faktit, që transporti qytetas është funksion ekskluziv i Bashkisë, Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), në nenin 10, gërma c)¹⁴, të tij parashikon edhe vendosjen e tarifës së shërbimit urban nga vetë Bashkia. Gjithashtu, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon se fondet për kompesimin e transportit qytetas përballohen nga Bashkitë.

Njëkohësisht, vlen të theksohet fakti se dikur ka ekzistuar një ndarje diskriminuese në legjislacionin shqiptar, në lidhje me përfitimin e lehtësirave për përfitimin e shërbimeve, duke trajtuar ndryshe dhe në mënyrë të padrejtë, kategori të ndryshme PAK, në situata thelbësisht të ngjashme. Kjo problematikë është ndrequr me miratimin e Ligjit 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, i cili mbështetur edhe në Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, eliminon çfarëdolloj diferencimi në thelb të aftësisë së kufizuar dhe garantimit të lehtësirave për të gjithë individët me aftësi të kufizuar. Në këtë këndvështrim, diferencimi midis invalidëve të punës, të cilët sipas ligjit të posaçëm¹⁵ përfitojnë transport falas dhe personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët mararin kompensim, jo vetëm që është i padrejtë dhe diskriminues, por tashmë është i tejkaluar dhe të njëjtat garanci, që ofrohen për një kategori duhen garantuar edhe për kategoritë e tjera. Nisur nga fakti që ofrimi i shërbimit të transportit për personat me aftësi të kufizuar, realizohet në mënyrën më të plotë dhe të thjeshtë duke e garantuar atë falas, kjo duhet të ndodhë për të gjitha kategoritë e individëve me aftësi të kufizuar, pa asnjë lloj dallimi apo diferencimi.

Për këtë arsye, mosnxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, që në vetvete përbën një mosveprim shumë të rëndë, nuk mund të shërbejë si pengesë për Bashkinë Shkodër për zgjidhjen përfundimtare të situatës, pasi rendi juridik i ofron të gjitha mundësitë, që transportin falas, Bashkia mund dhe duhet ta garantojë vetë, si duke nxjerrë aktet e nevojshme normative,

¹² Në referencë të neneve 22 dhe 23, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

¹³ Në referencë të nenit 24, të Ligjit nr. 139/2015. “Për vetëqeverisjen vendore”.

¹⁴ Neni 10, gërma c), i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon: “*Tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.*”.

¹⁵ Referuar neni 11, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës” (i ndryshuar);

ashtu edhe duke bërë parashikimet për përfitimin e shërbimit falas për personat me aftësi të kufizuar.

Së treti, mosveprimi i Bashkisë Shkodër kundrejt operatorit, i cili në mënyrë sistematike nuk ka respektuar detyrimet ligjore dhe kushtet kontraktore për garantimin e transportit falas për individët me aftësi të kufizuar, duke mos kryer monitorimet e nevojshme dhe duke mos marrë masat për mospërsëritjen e situatës, e ka vështirësuar përfitimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar dhe konkretisht për individët që i përkasin kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, deri në Janar të 2019, duke mos ia garantuar fare këtë lehtësi, pas muajit Janarit 2019. Kjo situatë i ka ekspozuar individët paraplegjikë e tetraplegjikë në Shkodër kundrejt një situatë të padrejtë, disfavorizuese dhe diskriminuese duke i vendosur atyre pengesa institucionale, të cilat mund dhe duhej të ishin rregulluar.

Njëkohësisht, nga analizimi i Kontratave të Shërbimit, që Bashkia Shkodër ka lidhur me operatorët e shërbimit urban qytetas, rezulton se në nenin 23 të tyre ka parashikime të sakta lidhur me detyrimin e operatorëve urbanë, për të ofruar transport falas për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Nga shqyrtimi i të gjithë provave të depozituara pranë Komisionerit rezultoi se vetëm njëri prej operatorëve të shërbimit nuk ka zbatuar detyrimin e tij kontraktual.

Detyrimi për të siguruar shërbim falas në transportin urban qytetas parashikohet edhe në çertifikatat dhe liçencat e operatorëve të shërbimit. Bashkia Shkodër është autoriteti përgjegjës që lëshon çertifikatat dhe licencat për këta operatorë. Operatori i shërbimit “Ergys 2010MS” sh.p.k. nuk ka zbatuar përcaktimet në dokumentet e mësipërme dhe ka paraqitur këtë problematikë që prej vitit 2015. Pavarësisht kësaj, Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë asnjë masë ndaj këtij subjekti.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Shkodër nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kësaj kategorie individësh me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi. Komisioneri gjykon se ekzistojnë të gjitha provat shkresore që vërtetojnë faktin se operatori i shërbimit urban “Ergys 2010MS”, ka qenë recidiv në mosbindjen e tij ndaj dispozitave të kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë e Shkodrës, si në vitin 2012, ashtu edhe në atë të 2018. Pavarësisht këtij fakti, ndaj tij nuk është ndërmarrë asnjë masë nga ana e Bashkisë Shkodër, fakt që Komisioneri e konsideron si një mosveprim të këtij institucioni, që e ka ekspozuar kategorinë e individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, të këtij qyteti, ndaj diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar.

B/2. Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “përkatësinë në një grup të veçantë”.

Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, pranon diversitetin e personave me aftësi të kufizuara. Një nga parimet themelore të kësaj konvente është parimi i mosdiskriminimit. Ky parim ka të bëjë jo vetëm me mosdiskriminimin e personave me aftësi të kufizuara në raport me personat e tjerë, por edhe brenda kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Gjatë hetimit administrativ dhe gjatë shqyrtimit në tërësi të ankesës nr. 192, datë 18.12.2018, e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës, përfaqësuar nga kryetarja e saj, Znj. Gj. N., Komisioneri konstatoi se problematika e shfaqur nga shoqata ankuese ndaj kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, ishte problematikë e njohur edhe për grupe të tjera individësh me aftësi të kufizuara, të tillë si invalidët e punës. Shkresat e Shoqatës së Invalidëve të Punës së Shqipërisë, Dega Shkodër, drejtuar Bashkisë Shkodër, ku shfaqet shqetësimi, lidhur me mos ofrimin e lehtësirave në transportin publik reflektojnë në mënyrë evidente të njëjtin shqetësim, sikurse ai i parashtruar në ankesën e Shoqatës Shkodrane të Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se në kushtet kur problematika e sigurimit të lehtësirave në transportin urban qytetas, ndeshet edhe në kategori të tjera individësh me aftësi të kufizuara, nuk ka diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë nga ana e Bashkisë Shkodër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (të ndryshuar), ligjin nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 6 e nenin 20, të ligjit nr.93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, nenin 85, të ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar), nenin 23, pika 6 dhe nenin 26, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nga ana e Bashkisë Shkodër.
2. Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Shkodër, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.
3. Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë Vendim, Bashkia Shkodër të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI